



Prishtinë, 29.01.2024  
Kodi i ZRRE-së: V\_1868\_2024

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2479\_12\_23** i dt.19.12.2023;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **09.01.2024**.

në seancën e mbajtur më datë **29.01.2024** nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin V.L nga komuna e Prishtinës, si e pa bazuar.
- II. **MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK\_V\_2479\_12\_23 i dt.19.12.2023.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me datë 19.12.2023 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK\_V\_2479\_12\_23 me të cilin e ka aprovuar ankesën e konsumatorit, me të cilën ankesë e ka kontestuar përgjigjën e KESCO-s – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 18.05.2023 lidhur me kontestimin e faturës së muajit prill 2023 për shkak të dyshimit në leximin dhe faturimin jo të saktë me njehsorin elektrik nr. 67783349.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Kundërshton vendimin e DMK-së dhe konstaton se i njëjti është i padrejtë;
- Pretendon se faturimi dhe korrigjimi i konsumatorit është real;
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2479\_12\_23 i datës 19.12.2023 për konsumatorin V.L

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2024 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin e KESCO se vendimin nr. ZRRE/DMK\_V\_2479\_12\_23 i datës 19.12.2023 i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nuk është i drejtë, Bordi pas shqyrtimit të të gjitha



provave dhe shkresave si: Faturat nr. 0423423DPR-90075728 datë 02.05.2023 dhe nr.0423323DPR-90075728 datë 02.05.2023; Ankesa e konsumatorit ne KESCO date 28.04.2023; përgjigja e KESCO-s date 18.05.2023; korrjigjimit nr. 102228DPR-90075728 datë 10.05.2023; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 20.09.2023; Vendimi i DMK-së nr. ZRRE/DMK\_ V\_2479\_12\_23 i datës 19.12.2023, Transaksionet e konsumatorit; Rrjedha e energjisë elektrike, listat e leximi, ka gjetur se nuk ka dyshime që vendimi i marrë nga DMK-ja është vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

ZRrE ka vërejtur se, Departamenti i faturimit ne KESCO me datë 02.05.2023 i ka dërguar konsumatorit dy fatura mujore të energjisë elektrike për periudhën prill 2023, njëren me **931 kWh** apo e shprehur ne vlerë financiare **59.88€** si dhe tjetrën me **4,347 kWh** apo e shprehur ne vlerë financiare **497.85€**. Me datë 28.04.2023 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar faturën e muajit prill 2023 për shkak të dyshimit në leximin dhe faturimin jo të saktë me njehsorin elektrik nr. 67783349. Me datë 18.05.2023 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën e tij duke u bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike, leximet softuerike dhe me date 10.05.2023 ka bere korrjigjimin financiar ne vlerë - **72.08€** duke bere shpërndarjen e kWh per periudhën 12/2022 deri ne periudhën 04/2023.

Bordi i ZRRE ka analizuar rrjedhën e përgjithshme te energjisë elektrike si dhe listat e leximit dhe konstaton se lexuesi i KEDS-it ka bere inspektime te rregullta mujore por qe ne disa periudha ka evidentuar se nuk ka qasje ne leximin e njehsorit elektrik përfshi edhe periudhën kontestuese 12/2022 deri ne periudhën 04/2023. Mos qasja e lexuesit te KEDS-it ne leximet e shpenzimeve mujore te konsumatorit është ne kundërshtim me nenin nenit 25 paragrafi 1te Rregullës per Kushtet e Përgjithshme te Furnizimit me Energji e ku thuhet se: 1. *Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji.*

Bordi i ZRRE ka vërejtur se pas ankesës se konsumatorit, Departamenti i faturimit në KESCO me datë 10.05.2023 përmes korrjigjimit nr. 102228DPR-90075728 ka bërë korrjigjimin e faturës 04/2023 ne vlerë financiare **-72.08€** duke bere korrjigjimin e kWh muaj per muaj duke marrë per bazë shpenzimet e regjistruara ne njehsorin elektrik nr. 67783349. Sipas te dhënave te cilat i ka dërguar KEDS/KESCO mbi te dhënat e regjistruara ne njehsorin elektrik vërtetohet se njehsori elektrik ruan te dhënat e leximit ne fillim te muajit përkatësisht me datë 1 te çdo muaji kurse leximet e konsumatorit bëhen ne ditën e 20 ose 23 te çdo muaji. Bordi i ZRRE ka analizuar korrjigjimin nr. 102228DPR-90075728 të datës 10.05.2023 dhe konstaton se ky korrjigjim nuk paraqet shpenzimet reale te konsumatorit per periudhat kontestuese pasi qe i njëjti është dashur te përputhët me ditët e leximit dhe se ne rastin tjetër kWh te shpërndahen per ditë por që KESCO nuk e ka bërë këtë shpërndarje, andaj konstatohet se Departamenti i faturimit në KESCO nuk ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: 3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrjigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese. ZRRE duke pasur parasysh se ky korrjigjim nuk është i saktë konstaton se konsumatorit duhet ti behet korrjigjimi ne vlerë **-195.96 €** duke bere shpërndarjen e kWh per periudhën 12/2022 deri ne periudhën 04/2023.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se i licencuari KESCO në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2024 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, e ne veçanti rrjedhën e energjisë elektrik, listat e leximit, transaksionet e konsumatorit, korigjimin nr. 102228DPR-90075728 datë 10.05.2023 si dhe nenit 28 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**III.** Vendimi nxirret dhe publikohet ne gjuhete zyrtare në Republikën e Kosovës.

**IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, kryesues

\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, anëtare

\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, anëtar

\_\_\_\_\_  
Arta Qorolli, anëtare

\_\_\_\_\_  
Adnan Preniqi, anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KESCO-s,
- Konsumatorit **V.L** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.